




Çfarë ndodh pas diplomimit nga shkolla?

Rezultatet nga gjurmimi i
të diplomuarve **2018-2020**



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



REPUBLIKA E ALBANI
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

Zbatuar nga:



SHKOLLA TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2018-2020

Tetor 2021

Ky raport është hartuar nga Jetmira Hotaj nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinatorë për gjurmimin në shkollën Teknike Ekonomike Tiranë: Jonida Nano.

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J


Rruga Skënderbej, Vila nr. 49
Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare 2891
Tel: +355 42 231 850
e-mail: al.info@swisscontact.org
www.aftesiperpune.al

1. Hyrje – Cfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëllojshme, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, **shkolla Teknike Ekonomike Tiranë**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përfundimtare të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **tre brezave me të diplomuar** të shkollës së mesme profesionale Teknike-Ekonomike Tiranë.

2. Të diplomuarit 2018-2020

Tabela 1 përmbledh shkallën e pjesëmarrjes në gjurmim, ndërsa tabelat në vijim i ndajnë sipas gjinisë dhe drejtimeve mësimore të të diplomuarve. 64% e të diplomuarve të 2020 u gjurmuar një vit pas diplomimit.

Tabela 1 Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2017-2018	200	114	57%
2018-2019	260	180	69%
2019-2020	237	152	64%

Tabela 2 Të diplomuar sipas drejtimeve për vitin mësimor 2019-2020

Drejtimi	Gjithsej	Të anketuar	%
Ekonomi-Biznes	220	139	63%
Tekstil-Konfeksion	17	13	76%

Tabela 3 Të diplomuar sipas gjinisë për vitin mësimor 2019-2020

Gjinia	Gjithsej	Të anketuar	%
Vajza	140	95	68%
Djem	97	57	59%

94% e të diplomuarve të anketuar banonin në Shqipëri në momentin e anketimit, ndërsa 6% jashtë Shqipërisë.

3. Rezultatet

Gjetjet kryesore paraqiten më poshtë të organizuara sipas qëllimeve kryesore të sistemit të gjurmimit.

3.1 Statusi i punësimit

Një vit pas diplomimit, cili është statusi i punësimit për të diplomuarit e shkollës?


- Përqindja e të diplomuarve të anketuar që shprehen se një vit pas diplomimit janë në marrëdhënie pune, ka pësuar rritje nga viti në vit. Në total, 60% e të diplomuarve në 2020 ishin të punësuar një vit pas diplomimit, krahasuar me 45% e të diplomuarve në 2019 dhe 25% e të diplomuarve në 2018.
- Përqindja e të diplomuarve të cilët ndjekin kualifikime të mëtejshme pa qenë pjesë e tregut të punës ka pësuar rënie nga 2018 në 2020. 24% e të diplomuarve të 2020 po vazhdonin kualifikime të mëtejshme, krahasuar me 38% të 2019 dhe 63% të 2018. Nga të diplomuarit e 2020, 26% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë.
- 16% e të diplomuarve të 2020 ishin të papunë, përkundrajt 17% të të diplomuarve të 2019 dhe 11% të të diplomuarve të 2018.

Tabela 4 Statusi i punësimit një vit pas diplomimit (%)

	2018	2019	2020
I punësuar	21 (18%)	38 (21%)	40 (27%)
I vetëm-punësuar	8 (7%)	11 (6%)	11 (7%)
Punon dhe studion në të njëjtën kohë	0 (0%)	32 (18%)	40 (26%)
Student/Kursant	72 (63%)	68 (38%)	37 (24%)
I papunë	12 (11%)	31 (17%)	24 (16%)
Tjetër	1 (1%)	0 (0%)	0 (0%)
Total	114 (100%)	180 (100%)	152 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

Figura 1 Statusi i punësimit një vit pas diplomimit për të diplomuarit (%)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë. Baza e përgjigjeve: N₁=114, N₂=180, N₃=152

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

A lidhet puna aktuale e të diplomuarve me fushën e tyre të arsimit?

- Vetëm për 37% të të diplomuarve në marrëdhënie pune, puna e tyre aktuale lidhej me fushën e tyre të arsimit. Kjo përqindje është ulur nga 52% që ishte në 2019.
- Të pyetur pse nuk lidhej puna me fushën e tyre të arsimit, 64% nuk kishin gjetur një vend pune që lidhej me studimet e tyre, ndërsa 23% po punonin në një punë që u ofronte kushte më të

mira edhe pse nuk ishte relevante me arsimin. 6% nuk dëshironin të punonin në një punë që lidhej me studimet e tyre.

Tabela 5 Puna lidhet me fushën e arsimit (%)

	2018	2019	2020
Po	11(38%)	42 (52%)	34 (37%)
Jo	18 (62%)	39 (48%)	57 (63%)
Total	29 (100%)	81 (100%)	91 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

3.3 Niveli i pagave

Cili është niveli i pagave për të diplomuarit e punësuar një vit pas diplomimit?


- 21% e të diplomuarve në marrëdhënie pune kishin të ardhura neto më pak se paga minimale.
- 34% e të diplomuarve kishin të ardhura në intervalin pagë-minimale deri 35,000 LEK, ndërsa 22% në intervalin 35,001-50,000 LEK.
- Ndërkohë, 23% e të diplomuarve kishin të ardhura më shumë se 50,000 LEK.

Tabela 6 Niveli i pagave një vit pas diplomimit - neto (%)

	2018	2019	2020
Më pak se paga minimale	0 (0%)	11 (14%)	19 (21%)
Paga minimale – 35,000 LEK	11 (38%)	38 (47%)	31 (34%)
35,001 – 50,000 LEK	13 (45%)	15 (18%)	20 (22%)
50,001 – 65,000 LEK	2 (7%)	7 (9%)	7 (8%)
65,001 – 80,000 LEK	1 (3%)	5 (6%)	5 (5%)
Më shumë se 80,001 LEK	2 (7%)	5 (6%)	9 (10%)
Total	29 (100%)	81 (100%)	91(100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

Figure 2 Statusi i punësimit një vit pas diplomimit për të diplomuarit (%)



3.4 Kushtet e punës

Cilat janë karakteristikat kryesore dhe kushtet e punës për grupin e diplomuarve të punësuar?

- Një pjesë e madhe e të diplomuarve në marrëdhënie pune, në të tre brezat e gjurmuar, deklaruan se ishin të angazhuar në mikro-ndërmarrje me nga 1 deri 9 punonjës. Përkatesisht, 38% e të punësuarve të diplomuar në 2018, 54% të 2019 dhe 61% e atyre të 2020. Ndërkohë që në biznese me mbi 50 punonjës deklaruan se punonin 7 nga 21 të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2018, 19 nga 70 të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2019 (ose 27%) dhe 14 nga 80 të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2020 (ose 18%).
- Pjesa dërrmuesve e të diplomuarve të punësuar, punonin me kohë pune të plotë (nga 79%-87%).


- Kontratë me afat të pacaktuar deklaruan të kishin lidhur 7 nga 20 të punësuarit e 2018, 32 nga 70 të 2019, dhe 27 nga 80 të punësuarit e 2020. Ndërkohë, 7 të diplomuar të punësuar të 2018, 25 të diplomuar të 2019 dhe 41 të diplomuar të 2020 raportotuan se nuk kishin lidhur kontratë me punëdhënësin e tyre për rregullimin e marrëdhënieve të punës.
- Pjesa dërrmuesve e të anketuarve, në të tre brezat e të diplomuarve, u shprehen se punëdhënësi i tyre u paguante pjesën e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Një gjë e tillë u pohua nga 90% e të diplomuarve në marrëdhënie pune të 2018, 62 ose 89% e të diplomuarve të 2019, dhe 60 ose 75% e të diplomuarve në 2020.

Tabela 7 Numri i punonjësve në kompani (%)

	2018	2019	2020
1-4 punonjës	3 (14%)	17 (24%)	22 (27%)
5-9 punonjës	5 (24%)	21 (30%)	27 (34%)
10-49 punonjës	6 (29%)	13 (19%)	17 (21%)
>50 punonjës	7 (33%)	19 (27%)	14 (18%)
Total	21 (100%)	70 (100%)	80 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

Figura 3 Kohë e plotë vs. kohë e pjeshme (%)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë. **Baza e përgjigjeve:** N₁=21, N₂=70, N₃=80.

Tabela 8 Kushtet e punës (%)

	2018	2019	2020
Kontrata me punëdhënësin			
Kontratë me afat të caktuar	6 (30%)	12 (17%)	10 (12%)
Kontratë me afat të pacaktuar	7 (35%)	32 (46%)	27 (34%)
Po bëj praktikën	0 (0%)	1 (1%)	2 (3%)
Pa kontratë	7 (35%)	25 (36%)	41 (52%)
Total	20 (100%)	70 (100%)	80 (100%)
Pagesa e kontributeve nga punëdhënësi			
Po	19 (90%)	62 (89%)	60 (75%)
Jo	2 (10%)	7 (10%)	15 (19%)
Nuk e di	0 (0%)	1 (1%)	5 (6%)
Total	21 (100%)	70 (100%)	80 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

3.5 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjehen të diplomuarit në vendin e tyre të punës?

- 7 nga 21 të diplomuarit e punësuar të 2018, 43 nga 70 të diplomuarit e punësuar të 2019 dhe 48 nga 80 të punësuarit e 2020, e perceptonin punën e tyre aktuale si “të sigurt ose shumë të sigurt”. Nga ana tjetër, 4 të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2018, 16 të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2019 dhe 7 të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2020 e perceptonin si “të pasigurt ose shumë të pasigurt” punën e tyre.
- Ndërsa në lidhje me perceptimin e kënaqshmërisë me vendin e punës, janë 6 nga të diplomuarit në marrëdhënie pune të 2018, 50 të 2019 dhe 58 të 2020 të cilët shprehen se janë

“të kënaqur ose shumë të kënaqur” me vendin e punës. Ndërkohë që 13 të diplomuarit e punësuar të 2018, 8 të 2019 dhe 12 të 2020, kanë një perceptim neutral.

Tabela 9 Stabiliteti në punën aktuale (%)

	2018	2019	2020
Stabiliteti në punën aktuale			
Shumë (i pasigurt)	1 (5%)	5 (7%)	5 (6%)
I/E pasigurt	3 (14%)	11 (16%)	2 (3%)
As i sigurt as i pasigurt	10 (48%)	11 (16%)	25 (31%)
I/E sigurt	6 (29%)	29 (41%)	25 (31%)
Shumë (i sigurt)	1 (5%)	14 (20%)	23 (29%)
Total	21 (100%)	70 (100%)	80 (100%)
Kënaqshmëria me vendin e punës			
Shumë (i pakënaqur)	0(0%)	2(3%)	7(9%)
I/E pakënaqur	2(10%)	10(14%)	3(4%)
As i kënaqur (as i pakënaqur)	13 (62%)	8 (11%)	12 (15%)
I/E kënaqur	6 (29%)	35 (50%)	33 (41%)
Shumë (i/e kënaqur)	0 (0%)	15 (21%)	25 (31%)
Total	21 (100%)	70 (100%)	80 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

3.6 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Sa duhet të presin mesatarisht të diplomuarit derisa të fillojnë punën e tyre të parë?

- Përafërsisht gjysma e të diplomuarve në 2020 e kishin gjetur punën e tyre të parë që para se të diplomoheshin nga shkolla (49%). Ka një ulje me të diplomuarit e 2019, ku 67% e tyre ishin integruar në tregun e punës që para diplomimit.
- Kohëzgjatja e kërkimit për punë varion për të diplomuarit siç është paraqitur në formë tabulare më poshtë. 74% e të diplomuarve në 2020, e kishin gjetur punën e tyre të parë brenda 3 muajve pas diplomimit.
- Këto numra përfshijnë edhe ata të diplomuar që mund të mos jenë në marrëdhënie pune gjatë momentit të anketimit, por kanë qenë të punësuar më parë.

Tabela 10 Gjetja e punës së parë (%)

	2018	2019	2020
Para diplomimit	19 (50%)	63 (67%)	47 (49%)
1 muaj pas diplomimit	2 (5%)	6 (6%)	11 (12%)
1-3 muaj pas diplomimit	1 (3%)	12 (13%)	12 (13%)
3-6 muaj pas diplomimit	9 (24%)	4 (4%)	8 (8%)
6-9 muaj pas diplomimit	2 (5%)	5 (5%)	10 (10%)
9-12 muaj pas diplomimit	5 (13%)	4 (4%)	8 (8%)
Total	38 (100%)	94 (100%)	96 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

3.7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Si e gjejnë të diplomuarit punën e tyre të parë?

- Njohjet, lidhjet familjare apo miqtë ishin mënyra sesi pjesa më e madhe e të diplomuarve në tre brezat e gjurmuar kishin gjetur punën e tyre të parë. Konkretisht, 63% e të anketuarve të 2018, 57% e të anketuarve të 2019 dhe 52% e të anketuarve të 2020 u shprehën se kishin shfrytëzuar kontaktet personale për t'u bërë pjesë e tregut të punës.

- Shpalljet për punë në faqet e internetit, mediat sociale, gazeta etj. u kishin ardhur në ndihmë për të gjetur punë, 10 nga 30 të anketuarve të 2018, 24 nga 83 të anketuarve të 2019 (29%) dhe 21 nga 85 të anketuarve të 2020 (25%).
- Kontaktimi i drejtëpërdrejtë i punëdhënësit është mënyra se si 10 ose 12% e të diplomuarve të 2019 dhe 14 ose 14% e të diplomuarve të 2020, kishin gjetur punën e tyre të parë.
- Ndërkohë, 1 i diplomuar i 2019 dhe 2 të diplomuar të 2020 kishin gjetur punën e tyre të parë nëpërmjet praktikës profesionale në biznes.
- Këto numra përfshijnë edhe ata të diplomuar që mund të mos jenë në marrëdhënie pune gjatë momentit të anketimit, por kanë qenë të punësuar më parë – pasi pyetja i referohet punës së parë pas mbarimit të shkollës.

Si i ndihmon shkolla gjatë periudhës së tranzicionit drejt tregut të punës?


- Përsa i përket ndihmës që shkolla u ka dhënë të anketuarve për të gjetur punën e tyre të parë, 23 nga 91 të diplomuarit e 2020 pohojnë se shkolla i ka orientuar për mundësitë e ndryshme të punësimit (25%), në krahasim me 40 nga të diplomuarit e 2019 (43%), dhe 7 nga të diplomuarit e 2018 që pohojnë një gjë të tillë.
- 12 të diplomuar të 2018, 59 të 2019 dhe 61 të 2020 pohuan ndihmën që shkolla i kishte asistuar duke i mësuar se si të kërkojnë për punë.
- Nga ana tjetër, 6 nga të diplomuarit e 2018, 21 nga të diplomuarit e 2019 dhe 40 nga të diplomuarit e 2020 mendojnë se shkolla nuk i ka ndihmuar për gjetjen e punës së parë.

Tabela 11 Renditja e mënyrave të gjetjes së punës së parë (%)

	2018	2019	2020
Nëpërmjet shpalljeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta etj	10 (33%)	24 (29%)	21 (25%)
Nëpërmjet njohjeve familjare, miqve, të njohurve	19 (63%)	47 (57%)	44 (52%)
Nëpërmjet praktikës profesionale	0 (0%)	1 (1%)	2 (2%)
Duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësin tim	1 (3%)	10 (12%)	14 (17%)
Nëpërmjet Zyrës së Punësimit	0 (0%)	0 (0%)	1 (1%)
Tjetër	0 (0%)	1 (1%)	3 (3%)
Total	30 (100%)	83 (100%)	85 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numra të plotë.

Figura 4 Ndhimja e shkollës gjatë tranzicionit (%) – pyetje e shumëfishtë



3.8 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme Çfarë kualifikimi të mëtejshëm po ndjekin të diplomuarit?

- 24% e të diplomuarve të 2020 po ndiqnin studime të mëtejshme më kohë të plotë, ndërsa 26% të tjerë edhe punonin dhe studionin në të njëjtën kohë.
- Të pyetur rreth kualifikimeve të mëtejshme që po ndiqnin, pjesa dërrmuese e të diplomuarve në të tre brezat e gjurmuar, po studionin në iniversitet dhe konkretisht ishin 97% e të anketuarve të 2018, 97% e të anketuarve të 2019 dhe 92% e të anketuarve të 2020.
- Të pyetur rreth arsyes kryesore se pse po i ndiqnin studimet e mëtejshme, nevoja për të fituar një kualifikim më të lartë përmendet nga 26 prej 72 të diplomuarve të 2018, nga 20 prej 68 të të 2019 dhe 48 prej 77 të të 2020. Ndërsa 28 të 2018, 38 të 2019 dhe 15 të 2020 u shprehen se arsyeja kryesore që po ndiqnin kualifikimet e mëtejshme ishte rritja e mundësisë për të gjetur një punë më të mirë.
- Të diplomuarit e 2020 u pyeten nëse kualifikimet e mëtejshme po i ndiqnin në një institucion publik apo privat dhe rezultoi se 64% e tyre po vazhdonin kualifikimet e mëtejshme në institucione publike. Për 86% të të diplomuarve fusha e studimeve lidhej me shkollën që kishin bërë.

3.9 Të diplomuarit pa punë

Çfarë vështirësish hasin të diplomuarit që gjenden pa punë një vit pas diplomimit?

- Të pyetur rreth arsyes së papunësisë, të diplomuarit e 2020 përmendën si arsye kryesore mungesën e eksperiencës në punë (8 nga 11). Një perceptim të tillë kishin edhe 6 të diplomuar në 2019. Ndërkohë që mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur punë, u pohua si shkak i papunësisë së tyre nga 3 të papunësuarit e 2018, 5 të 2019 dhe 3 të 2020.
- 14 nga 24 të diplomuarit e papunë të 2020 po kërkonin për punë, ndërsa 10 nuk po kërkonin për punë.

Tabela 12 Arsyeja kryesore pas papunësisë (%)

	2018	2019	2020
Më mungon eksperiencia e punës	0 (0%)	6 (19%)	8 (57%)
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	2 (17%)	2 (7%)	1 (7%)
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	3 (25%)	5 (16%)	3 (21%)
Nuk ka punë në qarkun tim	4 (33%)	2 (7%)	1 (7%)
Jam i/e angazhuar në punë familjare (me rritjen e fëmijëve/punët e shtëpisë)	0 (0%)	2 (7%)	0 (0%)
Tjetër	3 (25%)	2 (7%)	1 (7%)
Nga situata e krijuar nga pandemia COVID-19	0 (0%)	12 (39%)	0 (0%)
Total	6 (100%)	12 (100%)	11 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

3.10 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Si lidhet puna aktuale e të diplomuarve të punësuar me degën dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve?

- Të pyetur se në çfarë shkalle, njohuritë e fituara në shkollë përdoren në punën e tyre për të diplomuarit e punësuar, afërsisht gjysma (ose 50%), 46 nga 91 të diplomuarit e anketuar të 2020, u shprehen se këto njohuri gjenin “aspak ose pak” përdorim në punën e tyre.
- Një perceptim neutral rreth përdorimit të njohurive të shkollës në punën e tyre aktuale, rezultoi të kishin 17 nga 91 të pyeturit e 2020 (ose 19%), të cilët u shprehen se këto njohuri gjetën “disi” përdorim në punën e tyre.
- Ndërkohë që rreth një e treta (31%) e të anketuarve të 2020, raportuan se njohuritë e shkollës gjetën “shumë ose jashtëzakonisht shumë” zbatim në punën e tyre.

- Përsa i përket lidhjes së pozicionit të punës me studimet, jemi pothuajse në të njëjtën linjë me përdorimin e njohurive në punë. Janë 58% e të anketuarve që shprehen se pozicioni i punës lidhet “aspak/pak” me studimet e tyre. Ndërkohë që vetëm 28% e të anketuarve e shihnin pozicionin e punës si “shumë ose jashtëzakonisht shumë” të lidhur me studimet.

Tabela 13 Përdorimi i njohurive të fituara dhe lidhja e pozicionit me studimet (%)

	2018	2019	2020
Përdorimi i njohurive të fituara			
Aspak/pak	15 (52%)	34 (36%)	46 (50%)
Disi	8 (28%)	23 (25%)	17 (19%)
Shumë/Jashtëzakonisht shumë	6 (21%)	37 (39%)	28 (31%)
Total	29 (100%)	94 (100%)	91 (100%)
Lidhja e pozicionit aktual me studimet			
Aspak/pak	16 (55%)	41 (44%)	53 (58%)
Disi	8 (28%)	24 (26%)	13 (14%)
Shumë/Jashtëzakonisht shumë	5 (17%)	29 (31%)	25 (28%)
Total	29 (100%)	94 (100%)	91 (100%)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Për t'i përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës, në çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla?

- Në një vlerësim retrospektiv, përqindja më e lartë e të diplomuarve të 2020 veçuan si aspekte të shkollës që kanë nevojë për “shumë ose jashtëzakonisht shumë” përmirësim: praktikën në biznes (n=99/69%), bashkëpunimin e shkollës me zyrat e punësimit (n=95/65%), praktikën në shkollë (n=92/64%), si dhe tekstet dhe materialet për të mësuar (n=75/56%).
- Në një vlerësim retrospektiv të diplomuarit u pyetën edhe nëse do të zgjidhnin të njëjtën shkollë dhe të njëjtën degë studimi dhe nga rezultati doli se 80% do bënin të njëjtën zgjidhje në lidhje me shkollën dhe pëafërsisht po aq (78%) ishin të gatshëm të zgjidhnin po të njëjtën degë në të cilën ishin diplomuar.


Tabela 14 % e të diplomuarve që raportojnë se fusha duhet të përmirësohet “shumë/jashtëzakonisht shumë”

		Aspak/pak	Disi	Shumë/jashtëzakonisht shumë	Total
Infrastruktura	2018	13 (45%)	7 (24%)	9(31%)	29 (100%)
	2019	42 (45%)	27 (29%)	25(27%)	94 (100%)
	2020	26 (20%)	44 (33%)	63 (47%)	134 (100%)
Tekstet dhe materialet për të mësuar	2018	8 (28%)	12 (41%)	9 (31%)	29 (100%)
	2019	32 (34%)	36 (38%)	26 (28%)	94 (100%)
	2020	19 (14%)	40 (30%)	75 (56%)	134 (100%)
Metodat e mësimdhënies	2018	7 (24%)	11 (38%)	11 (38%)	29 (100%)
	2019	29 (31%)	34 (36%)	31 (33%)	94 (100%)
	2020	28 (21%)	38 (28%)	70 (51%)	136 (100%)
Praktika në shkollë	2018	12 (41%)	9 (31%)	8 (28%)	29 (100%)
	2019	32 (34%)	27 (29%)	35 (37%)	94 (100%)
	2020	20 (14%)	31 (22%)	92 (64%)	143 (100%)
Praktika në biznes	2018	12 (41%)	9 (31%)	8 (28%)	29 (100%)
	2019	25 (27%)	28 (29%)	41 (44%)	94 (100%)
	2020	18 (13%)	26 (18%)	99 (69%)	143 (100%)
Bashkëpunimi i shkollës me	2018	9 (31%)	13 (45%)	7 (24%)	29 (100%)
	2019	14 (15%)	27 (29%)	53 (56%)	94 (100%)

zyrat e punësimit	2020	22 (15%)	29 (20%)	95 (65%)	146 (100%)
--------------------------	------	----------	----------	----------	-------------------

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë.

Figure 5 Zgjedhja në retrospektivë për të diplomuarit e 2020 (%)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë. **Baza e përgjigjeve:** N=152.

3.12 Planet për të ardhmen

Çfarë planesh kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm?

- Punësimi mbetet pjesë kryesore e planit afat-shkurtër të pjesës më të madhe të të diplomuarve në 2020. Gjysma e të diplomuarve të anketuar (50%) po planifikonin që në të ardhmen e afërt të gjenin një punë që lidhet me fushën e tyre të studimeve. Ndërsa gjetja e një punë si mënyrë për t'u punësuar, pavarësisht lidhjes ose jo me fushën e studimeve, ishte pjesë e planit afat-shkurtër të 7% të të diplomuarve.
- Një numër i konsiderueshëm nga të diplomuarit e 2020 (40% e të anketuarve) u shprehën se një vit pas diplomimit po planifikonin që në të ardhmën e afërt të hapnin biznesin e tyre.
- 26% të diplomuar të anketuar u shprehën se pjesë të planit të tyre afat-shkurtër kishin ndjekjen e studimeve të mëtejshme.
- Ndërkohë, në 24% të rasteve, të diplomuarit e 2020 po planifikonin të emigronin jashtë vendit.

Figure 6 Planet për dy vitet e ardhshme (%)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numra të plotë. Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishtë. **Baza e përgjigjeve:** N₁ =114, N₂=180, N₃=152.

4. Përfundimet

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës Teknike Ekonomike Tiranë duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në 2018.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit **për të diplomuarit e 2020** janë përmbledhur më poshtë:

- 64% e të diplomuarve të 2020 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Përqindja e të diplomuarve të anketuar që shprehen se një vit pas diplomimit janë në marrëdhënie pune, ka pësuar rritje nga viti në vit. Në total, 60% e të diplomuarve në 2020 ishin të punësuar një vit pas diplomimit, krahasuar me 45% e të diplomuarve në 2019 dhe 25% e të diplomuarve në 2018.
- 24% e të diplomuarve të 2020 po ndiqnin studime të mëtejshme më kohë të plotë, ndërsa 26% të tjerë edhe punonin dhe studionin në të njëjtën kohë.
- Vetëm për 37% të të diplomuarve në marrëdhënie pune, puna e tyre aktuale lidhej me fushën e tyre të arsimit. Kjo përqindje është ulur nga 52% që ishte në 2019.
- 34% e të diplomuarve kishin të ardhura në intervalin pagë-minimale deri 35,000 LEK, ndërsa 22% në intervalin 35,001-50,000 LEK. Ndërkohë, 23% e të diplomuarve kishin të ardhura më shumë se 50,000 LEK.
- Përafërsisht gjysma e të diplomuarve në 2020 e kishin gjetur punën e tyre të parë që para se të diplomoheshin nga shkolla (49%). Ka një ulje me të diplomuarit e 2019, ku 67% e tyre ishin integruar në tregun e punës që para diplomimit.
- Në një vlerësim retrospektiv, përqindja më e lartë e të diplomuarve të 2020 veçuan si aspekte të shkollës që kishin nevojë për “shumë ose jashtëzakonisht shumë” përmirësim: praktikën në biznes (69%), bashkëpunimin e shkollës me zyrat e punësimit (65%), praktikën në shkollë (64%), si dhe tekstet dhe materialet për të mësuar (56%).
- Nëse do të kishin mundësi, 80% do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë ndërsa 78% do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim profesional.